

DREJTORIA E RAJONIT JUGOR GJIROKASTER
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 14.12.2018

Për: „Eral Konstruksion”shpk & ”Alb Shpresa” shpk me adrese Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Pall. Nr. 23, Kulla B, Kati 9, Apt. 36, Tirane.

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur, sherbime.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF – 74001 -06- 07-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Mirembajtje rutine e dimerore me performance rruga Ura e Leklit – Kelcyre + rruga Kelcyre – Permet + rruga Valare – Erind – Cajup + rruga K/Dhuvjan – Libohove 63,3 km**“ *per nje periudhe 2-vjecare.*

Fondi limit : 37 526 939 leke pa tvsh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike dt. 11.06.2018 nr. 23.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike ”Eral Konstruksion”shpk & ”Alb Shpresa” shpk
NIPT K82230002K; NIPT :J72110003F

Vlera: 25 405 720(njezet e pese miljon e katerqind e pese mije e shtateqind e njezet) leke pa tvsh

2."Jodi Company" shpk NIPT : J94824803M

Vlera : 27 733 000 (njetzet e shtate miljon e shtateqind e tridhjetë e tre mijë)leke pa tvsh

3."Beqiri "shpk NIPT:J98624801V,

Vlera 32 255 200(tridhjetë e dy miljon e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind)leke pa tvsh

4."Vagalat" shpk &"Curri"shpk NIPT: J69102503I NIPT : J679027185S

Vlera 33 484 202 (tridhjetë e tre miljon e katerqind e tetëdhjetë e kater mijë e dyqind e dy) leke pa tvsh.

5."Cobial" shpk NIPT :

Vlera 35 673 200 (tridhjetë e pesë miljon e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind) lek pa tvsh

6. Adem Pojani K51524013W (pa oferte)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "Eral Konstruksion "shpk &"Alb Shpresa"sh.p.k
2. "Beqiri"shpk
3. "Vagalat" shpk &"Curri"shpk
4. "Cobial" shpk

Perkatesisht per aryet e meposhtme:

1. Bashkimi i Operatoreve ekonomik "Eral Konstruksion" shpk & "Alb Shpresa" sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik "Autobitumatriçe", në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerases me subjektin GE & CO shpk, nenshkruar me date 05.07.2018, me afat qera 3 vite. Po ky mjet me targe TR4893L, i eshte dhene me qera dhe dy subjekteve te tjera 2 T shpk dhe Sterkaj shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben fiktive dhe te pavlefshme kete kontrate.

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetet teknike "grejder", në pronësi ose me qira, cope 1 dhe "asfaltoshtruese" në pronësi ose me qira, cope 1 operatori ekonomik Eral Konstruksion shpk ka paraqitur kontraten e qerases date 05.07.2018, nenshkruar me subjektin "Feba shpk". Po keto mjete me anen e kontrates se qerases date 27.04.2018, i jane dhene subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe ose qe perfshin kete, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

Per kapacitetin teknik "Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi", operatori ekonomik Caushi shpk ka paraqitur kontrate furnizimi date 06.06.2018, nenshkruar me subjektin "Feba shpk". Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti

“Eral Konstruksion shpk”, rezulton qe subjekti “Feba shpk”, date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

Operatori ekonomik nuk ka permbushur sic duhet piken 2.2.3, te kriterëve te dhena ne lidhje me detyrime te pashlyera te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2017.

Operatori ekonomik nuk ka permbushur sic duhet piken 2.2.3 ne lidhje me punesimin e inxhinjerit gjeodet.

2. Operatori ekonomik Beqiri shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit vertetimi NR.T00356452 date 13.06.2018 (Per pagim detyrimesh) dhe vertetimi nr.T00336858 date 04.06.2018 jane te panenshkruar elektronikisht

Per kapacitetin teknik “Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Beqiri shpk ka marre me qera impjantin nga subjekti “Spartaku shpk”, date 04.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Don Jurge shpk” pjesemrres ne kete procedure, rezulton qe subjekti “Spartaku shpk”, date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate furnizimi, me afat 2 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

3.Bashkimi i operateve ekonomike “Vagalat “ &”Curri”shpk rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne licencen profesionale te shoqerise Vagalat pjese e ketij bashkimi me nr.NZ 1929/9 date 19 .11.2012 dhe nga te dhenat e formularit E-SIG, rezulton se per te gjithë drejtuesit teknik nuk jane paguar sigurimet shoqerore

Ekstrakti i gjendjes aktuale te shoqerise leshuar nga QKB eshte i pa nenshkruar elektronikisht.

Subjekti “Vagalat “ pjese e ketij bashkimi nuk ploteson kriterin 2.3.1, kriterin e punimeve te ngjashme.

4.Operatori ekonomik “Cobial” shpk rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Oferta ekonomike mbart gabime aritmetike ne vlere me shume se 2% te vleres se ofertes ekonomike te ofruar.

Ka pasur ankesa nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion” shpk & “Alb Shpresa”shpk. Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.742/2018 ka vendosur te pranoje ankesen e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion”shpk & “Alb Shpresa”shpk, duke e kualifikuar kete Bashkim te Operatoreve Ekonomike. Nga ana e Autoritetit Kontraktor u be rivleresimi i ofertave ne daten 20.11.2018 duke kualifikuar dhe klasifikuar fitues Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion”shpk & “Alb Shpresa”shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion” shpk & “Alb Shpresa” me adrese Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Pall. Nr. 23, Kulla B, Kati 9, Apt. 36, Tirane, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej

25 405 720 (njezet e pese miljon e katerqind e pese mije e shtateqind e njezet) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise se Rajonit Jugor Gjirokaster, nr. tel. 084262529 me adrese, ish Zona Industriale Gjirokaster, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.11.2018

Ankesa: Ka pasur ankesa nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion“shpk,” & “Alb Shpresa“shpk,” ne daten 10.08.2018 prane AK. Ka marrë përgjigje në datë: 15.08.2018, me shkresen nr. 555 nga AK . Ne daten 24.08.2018 ky subjekt ka paraqitur ankesë prane KPP .Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.742/2018 ka vendosur te pranoje ankesen e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion“shpk & “Alb Shpresa”shpk, duke e kualifikuar kete Bashkim te Operatoreve Ekonomike. Nga ana e Autoritetit Kontraktor u be rivleresimi i ofertave ne daten 20.11.2018 duke kualifikuar dhe klasifikuar fitues Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Eral Konstruksion“shpk & “Alb Shpresa”shpk.